



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, datë 19.02.2026, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për miratimin e disa shtesa dhe ndryshimeve në Vendimin nr. 2, datë 16.01.2020 të AMA-s për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së shërbimit të programit audioviziv”.
2. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 29, datë 22.12.2025 për dënimin me gjobë, të shoqërisë “Top Channel” sh.a.

(Vendim nr. 16, datë 19.02.2026)

3. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në vendimin nr. 98, datë 07.06.2017 të AMA-s, “Për miratimin e Numrit Logjik të programit të shërbimeve programore të përgjithshme dhe shërbimeve programore private rajonale/lokale”, i ndryshuar, sipas tabelës me listën e NPL-ve bashkëlidhur këtij vendimi.

(Vendim nr. 17, datë 19.02.2026)

4. Dhënien e autorizimit shoqërisë “Media Vizion” sh.a., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, online, mbështetur në rrjet IP (OTT) “Media Vizion”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare

(Vendim nr. 18, datë 19.02.2026)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 19 Shkurt 2026